



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 342/ 22 prot.

Datë 08.04.2024

V E N D I M
Nr. 355/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 270/2024, datë 12.03.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “*Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore*”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Vale Recycling*” SHPK me NIPT L28029301Q, me adresë: Fshati Gurëz, afër ish kanalit të Acidit, Kurbin.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për*

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 07.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 252/2024, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Vale Recycling” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Glliozheni Tiranë.*
- 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.*
- 3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Në datë 13.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 279/2024, ku vendosi:

Të korigjojë dispozitivin e Vendimit Nr.252/2024, datë 07.03.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik si më poshtë:

Ishte

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Vale Recycling” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë*

milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.

2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.*

3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Bëhet

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Vale Recycling” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.*

2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Vale Recycling” SHPK.*

3. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 18/21 prot, datë 18.02.2024, dhe Nr. 18/22 prot, datë 19.02.2024 dhe të publikoj shtojcën përkatëse të modifikuar.*

4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK*

5. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.3. Në datë 12.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 270/2024, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik, Koço Gliozheni Tiranë.*

2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Vale Recycling” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.4. Me shkresën nr. 316/2 prot., datë 02.04.2024, protokolluar me tonën nr. 342/19 prot., datë 04.04.2024, autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik, Koço Gliozheni Tiranë, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 270/2024, datë 12.03.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “*Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore’, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj*”, me fond limit 12,324,510 (*dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik, Koço Gliozheni Tiranë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. nr. 316/2 prot., datë 02.04.2024, protokolluar me tonën nr. 342/19 prot., datë 04.04.2024, autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik, Koço Gliozheni Tiranë, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 270/2024, datë 12.03.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “*Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore’, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj*”, me fond limit 12,324,510 (*dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik, Koço Gliozheni Tiranë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se autoriteti kontraktor ka dorëzuar Shtojcën nr. 316/1, datë 02.04.2024 nëpërmjetë të cilit ka vendosur të bëjë ndryshimet e dokumentave standarte të tenderit sipas përcaktimeve të vendimit KPP

270/2024, datë 12.03.2024. Në dokumentacionin bashkalidhur shkresës së sipërcituar konstatohet se autoriteti kontraktor në shtojcën e dorëzuar pranë KPP ka modifikuar dokumentat standarte të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 270/2024, datë 12.03.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave standarte të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P. 252/2024, datë 07.03.2024 dhe vendimin K.P.P 270/2024, datë 12.03.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Për sa më sipër nga verifikimi i kryer rezulton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin K.P.P 252/2024, datë 07.03.2024 dhe vendimin K.P.P 270/2024, datë 12.03.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik duke modifikuar dokumentat standarte të tenderit si dhe ka publikuar shtojcën përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore’, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik, Koço Gliozheni Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

